

I N F O R M A T I

Më datën 4.10.1991 -Hajvali

Si ditët e tjera edhe sot në oborrin e shkollës sonë është mbajtur protesta me nxënës, arsimtar dhe prindër. Për nga masoviteti ka qenë më masive se sa ditëve të tjera- Protesta ka filluar si zakonisht në ora 8³⁰, duke respektuar intervalin e kohë janë lexuar kërkesat si zakonisht edhe tri tekste nga nxënësit arsimtarët dhe preindërit . Gjatë kësaj kohe nuk patëm asnjë incident, edhe sot si- kurse dje u sollën milicija serbe por nuk hyri në oborrin e shkollës.

Në fund nxënës, arsimtar dhe prindër u shpërndan në mënyrë të qetë pasi u informuam që të veprojmë sipas lajmeve të Radio Zagrebit pasi për ne është i vetmi burim informimi. ~~XXXXXX~~

Hajvali

Më 4.10.1991

Komisioni informativ i

Shkollës Fillore "Shkendija"

Hajvali


